



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 10/12/2024

PRIMLJENO

Pro. No. R. 02/446



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja u mbajt me datë: 28.06.2024 dhe filloi në ora: 10:35.

Në mbledhje morë pjesë: 20 asambleistë, Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi, Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Sylë Dukolli, përfaqësues nga OSBE dhe zyra për informim.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Përsëritet për të gjithë dhe mirë se keni ardhur! Hapi mbledhjen e -I- (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit të Malishevës. Prezent në mbledhje jemi 20 anëtarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Para se të fillojmë tek rendi i ditës e kam një kërkesë që ka ardhur nga MAPL-ja, për rishqyrtim të vendimeve për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronave të ish ndërmarrjes OPB Mirusha dhe vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private dhe këmbimin e të njëjtës me pronë publike. Urdhërdho, Muharrem!

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Kryesues, për mos me qenë në kundërshtim me procedurën, rendi i ditës është i propozuar për mbledhje të jashtëzakonshme dhe ne ligjërisht nuk kemi të drejtë me ndryshuar, por pikat që i kemi që është obligim për me i shqyrtu për shkak se afati është deri me 18.07, i vendosim tek pikat të ndryshme dhe trajtohen si kërkesa. Mos me ndryshu rendin e ditës, por trajtohen si kërkesa mos me rënë në kundërshtim me Udhëzimin.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Muharremi, e cekim që nuk kemi të drejtë, por tek pikat e ndryshme paskemi të drejtë. Me 18.07 e ka afatin ligjor, ne para datës 15 e mbajmë një mbledhje për ato pika. Muharrem, tek pika të ndryshme a kemi të drejtë me i vendos këto?

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Trajtohen si kërkesa, merren vendime dhe kalojnë pa problem, por me ndryshu rendin e ditës në mbledhje të jashtëzakonshme nuk kemi të drejtë.

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Si i dërgon në MAPL vendimet.

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Bashkë me procesverbal, lexohet dhe trajtohet si kanë rrjedh ngjarjet.

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Ndoshta ka qenë mirë me qenë në seancë të rregullt dhe paska hapsirë deri me 18.07. Nuk mundemi me marr një vendim pa e marr me shqyrtu.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Rekomandimi i MAPL-së është që mos të bëhet dhe vendimi për këmbim por vendimi të jetë vetëm për shpallje të zonës me interes të përgjithshëm. Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Qështja e parë që më shqetëson, këto kanë ardhur me datë 18, mbledhja e KPF është mbajtur para 3-4 ditëve keni mundur me i shqyrtu aty, për mos me pas këso konkluzione. Këto janë kërkesa nga MAPL, e rendi jonë i ditës në këtë mbledhje shkon në MAPL për miratim, unë nuk besoj që MAPL gjenë diqka sepse është shkresa e tyre dhe nuk besoj që bien në kundërshtim.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Sa i përket kësaj pike, në seancën e kaluar u murr vendimi dhe ka qenë pikë e ndjeshme dhe nëse e ka kthyer MAPL-ja, më mirë do ishte me pas vendimin dhe me analizu. Kemi kohë deri në seancën e rregullt me marr një vendim dhe me dit ne se çka jemi duke votuar. Toka është e ndjeshme, parcela është e ndjeshme, prona publike është e ndjeshme, mos të marrim edhe një herë këso lloj vendimesh pa e analizuar. Ka qenë sfiduese mënyra si janë proceduar parcelat për me i këmbyer. Unë propozoj që të shtyhet në mbledhjen e ardhshme, ose të na vjen vendimi sot që ta analizojmë.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Materialin e keni secili. Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Këtu jemi që të krijojmë zgjidhje dhe konsideroj që secili nga ne duhet me i'u përgjigj kësaj. Nëse proceduralisht nuk e pengon për me marr vendim për këto dy qështje te pika të ndryshme, për mos me shty këtë në një mbledhje të rregullt, atëherë Kryesuesi mundet me thirr tani një mbledhje urgjente, që pas kësaj mbledhje me i përfunduar këto dy pika. Deri në atë kohë sekretaria e kuvendit përgadit materialin dhe shkresën që ju ka përcjell Ministria.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Shkojmë në pauzë 5 minuta me shefa të grupeve.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Kthehemi pas pauzës. Prezent jemi 24 anëtarë dhe mund të vazhdojmë me seancën. Kush është për këtë rend të ditës?
Me vota unanime të 24 anëtarëve, miratohet ky:

REND I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/209 datë: 21.05.2024.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2025-2027.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 04/571 datë:24.06.2024 për rritjen e kufirit të të hyrave vetanake për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne e kemi obligim me i ndryshuar vendimet, kur MAPL-ja na rekomandon për ti ndryshuar. Unë propozoj që gjatë kohës që diskutojmë në këtë mbledhje, le të përgaditet ftesa për mbledhje urgjente. Ky është qëndrimi i grupit tonë.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Unë e ceka dhe në takim, ne parimisht jemi për seancë të rregullt për këto dy pika por nëse ju po insistoni që të jenë brenda, jemi në rregull na shpërndani materialin mbesin tek pika të ndryshme. Unë prapë kam hezitim se te pika të ndryshme ka me pas telashe në MAPL-ë.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Si kryesues i kuvendit, konstatoj që duhet të thirret mbledhje urgjente.

Pika e parë

1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/209 datë: 21.05.2024.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Kjo është pikë e cila është shtyrë në mbledhjen e kaluar, për shkak të dilemave për vendimarrje. Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Është pronë e Ekonomisë së Pyjeve dhe menaxhohet nga ky Agjension i pyjeve, mirëpo ligji e specifikon që prona duhet të bëhet zonë me interes të përgjithshëm publik. Unë kam qenë në Ministri të pushtetit lokal dhe ata kanë gabuar në vlerësim sepse nuk e kanë pasur të qartë çka është prona publike dhe çka është prona shoqërore dhe ata thanë që për hir të korrektësisë dhe për shkak që shkresa është shpërndarë tek ju të njëjtën e rivotoni. E njëjta procedurë do të zbatohet në rastin konkret nuk është pronë shoqërore që menaxhohet nga AKP, por është pronë që menaxhohet nga Agjension i pyjeve. Për dy ari Ministria e Bujqësisë raportin e ka dhënë pozitiv. Komuna ata dy ari do ti merr për vete, do të

shkojnë në Ministri të pushteti lokal, do të përgaditet raport me shkuar në qeveri dhe nëse qeveria e pranon me trajtu dy ari të komunës së Malishevës e merr votimin dhe e bart në emër të Kuvendit Komunal. Pas katër viteve komuna prapë do e sjellë në kuvend për me dhënë në shfrytëzim.

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Nëse ju jeni të sigurt që kjo është punë e jona dhe nuk vjen për rishqyrtim sepse nëse vjen në rishqyrtim unë nuk do ta votoj për me shfuqizu atë vendim.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë po pajtohem me Halilin që thotë që a jeni të sigurt për me marr këtë vendim. Unë dua dhe një sqarim nga Muharremi, e kemi marrur një vendim si të ngjajshëm në shtatorin e kaluar. Në këto ndërtimet që i bëjnë shpesh ne kemi dhënë dhe leje për ndërtimin e këtyre shtëpive në fshatra, ato janë ndërtuar në pronë publike. Nëse nuk është rasti i njejtë, sqarona pse?

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Shtëpitë e komunitetit që po thua që i ndërtojnë komunitetet nëpër vendbanime, nuk janë që ato janë të kundërligjshme në kuptimin e ndërtesës e pronës sepse dhe ndërtesa dhe prona është e komunitetit. Ato na kthen Ministria e Planifikimit Hapësinorë me shkakun që në planin zhvillimor komunal nuk i ke planifikuar ti ato ndërtesa, për asnjë arsye tjetër nuk i kthen. Në momentin që Kuvendi merr vendim për me lejuar për pronën e vetë përgjegjës është Kuvendi komunal dhe pronën e vetë po e ndërton për komunitetin e vetë nuk po ia bart privatëve. Ministria e ambientit nuk po thotë që ti nuk ke drejtë me lejuar këtë por ti nuk e ke planifikuar planin zhvillimor komunal për me bërë këtë punë. Në rastin konkret aty nuk do të ndërtohet asgjë por do të vendoset një pllakë.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Ne si grup jemi pro me i mbështet.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Unë kontaktova me kryetarin që e ka bërë kërkesën dhe në bazë të tij nuk ka pasur ankesa të shumta dhe nuk është diqka për të keqen e fshatit. Ne si LDK-ë e mbështesim këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e kërkesës 02/209
datë:21.05.2024?

Me vota unanime, të 24 anëtarëve kjo pikë miratohet.

Pika e dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2025-2027. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtori për Buxhet dhe Financa): Para jush keni kornizën në të cilën janë të përcaktuar kufijtë për kornizën afatmesme buxhetore 2025-2027, me theks të veçantë për vitin 2025. Ministria e Financave ka parashikuar për vitin 2025 si total i buxhetit të jetë shuma 21,421,545E. Ne kemi bërë një ndryshim dhe para jush kemi kërkesë që të rritet drejtë për së drejti në aprovim buxheti për vitin 2025, rritja e të hyrave vetanake në 2,200.00E që si total i buxhetit për vitin 2025 të jetë 22,116,19E. Tek granti i përgjithshëm rritja është 8.9%, tek granti i arsimit kemi dhe këtu kemi një rritje prej 6.29%. Kemi zbritje tek granti i shëndetësisë prej 4.43%.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Këtu është duke u prezantuar një dokument i cili është obligim ligjor, ku në kuadër të kësaj përcaktohen kufij buxhetor për të gjitha organizatat buxhetore, mirëpo përcaktohen dhe kufij buxhetor lidhur me grantet e rregullta dhe specifike. Shihet një rritje total i buxhetit, mirëpo në qoftëse këtë rritje e analizojmë pak me fuqinë e blerësit parasë nënkupton që nuk ka rritje. Para një muaji diku 14.1% ka qenë norma e inflacionit, që i bie që fuqia blerëse ose në këtë rast vlera e parasë për me i kryer punimet, me i kryer shërbimet e veta komuna është më e vogël se sa vitin paraprak. Sa i përket rritjes së të hyrave vetanake kjo më tepër i atribuohet qytetarëve të cilët janë të përgjegjshëm ndaj obligimeve të cilat ju takojnë për pronën apo shërbimet që i ngarkojnë me taksa. Në kuadër të kësaj, pavarësisht që nuk janë të përcaktuar niveli i shpenzimit për kategoritë ekonomike është bërë një shpërndarje sa i përket këtyre kategorive. Është një rritje tek kategoria e investimeve kapitale nga 5.5 diqja milion në 6 milion.

Një rritje tjetër është tek mallra dhe shërbime ku në këtë vit i kemi 1,700.000 që është propozuar që të jetë 2,400.000. Po ashtu dhe tek subvencionet ka një rritje.

Tek planifikimi i të hyrave vetanake disa lloje të aktiviteve, komuna nuk inkason mjete nuk ka aso taksa dhe kisha propozuar që herën tjetër këto lloje shërbime që i kryen komuna të harmonizohen me Rregulloren për Taksa dhe Gjoba, sepse aty janë të specifikuara të gjitha llojet e të hyrave që krijon komuna. Disa komuna kanë mbajtur dëgjime publike me një format pak më gjanë dhe është përparësi nëse mundemi me mbajt. Testin ligjor që kërkohet për dëgjime publike është mbajt dëgjimi publik. Sot është afati i fundit jo veq me miratu por dhe me dorzu në qeveri. Unë kisha kërkuar me aprovu, nuk është dokument final por është dokument fillestar.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Unë mendoj që ky si dokument nuk ju ka nënshtruar dëgjimeve publike, nuk e di për qfarë arsye është duke ndodhur. Ju mundeni me bërë një dëgjim publik me i ftuar njerëzit në sallë këtu, me njerëz të juaj ose me kryetar të fshatrave por si dokument ka qenë shumë me rëndësi me dalë në lokalitet me i marr të gjitha kërkesat e qytetarëve që duhet të futen në buxhet. Unë mendoj që këtë procedurë KAB-i nuk e ka kaluar.

Çështjen e dytë që dua ta ngriti është pse po ndodh që të vjen në seancë të jashtëzakonshme, sepse kemi pasur mundësi të vjen në seancë të rregullt. Ne e dimë që 30 qersori është afati i

fundit, pse po ndodhin këto gjëra drejtor kur ne po kemi hapësirë të mjaftushme për trajtimin e këtij dokumenti për seanca të rregullta që të kenë mundësi dhe anëtarët e kuvendit të shtjellojnë më shumë, të hynë më shumë brenda dhe jo të vinë dy ditë para skadimit të afatit dhe të trajtohet në kuvend dhe nuk po më duket si praktik e mirë që të ju servohet njerëzve diqka me dëshirë apo pa dëshirën e tyre a votojnë a po jo. Drejtor, e kam një pyetje te regjistrimi i popullsisë, tek qarkorja e dytë a mundet me ndikuar regjistrimi i popullsisë te kjo pjesë, për shkak se me ramjen e popullsisë në Malishevë nëse dalin të dhënat zyrtare, a mundën me ndiku tek të hyrat e qeverisë.

Blerim Thaçi (Drejtori për Buxhet dhe Financa): Për vitin 2025 jo.

Kryesusi i Kuvendit Argëjend Thaçi: Sa i përket thirrjes së seancës së jashtëzakonshme ne e kemi mbajtur një seancë të rregullt në këtë muaj

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Suhareka e ka bërë në çdo fshat dhe në çdo lokalitet, unë vetëm këtë po e kërkoj ne a duhet të jemi më afër qytetarit apo me me i ik përgjegjësis qytetarit. Këtë e keni ditur që duhet të miratohet deri më 30 qershor që të trajtohet në një seancë të rregullt. Unë po kërkoj që të mbahet në një seancë të rregullt me e pas hapësira të debatit, sepse ka mundur të trajtohet edhe në seancën e kaluar të rregullt.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Pajtohem me Nebihin, që në dëgjime publike duhet të kemi më shumë kujdes. Kur të vjen qarkorja e dytë të kemi dëgjime publike prej anëtarëve të KPF-së, sepse ashtu është e përcaktuar dhe ligjërish, ndërsa për modelin dhe formën e orarit flasim dhe e rregullojmë kur vjen ai moment.

Sa i përket KAB-it e kam parë që është bërë një shpërndarje në shumicën e kategorive. Ajo çka kisha kërkuar në fund kur e merr dhe dritën e jeshile që votohet këtu në kuvend me u përmbajt me këto pika dhe pastaj me u përputh dhe në buxhetin final. Për vitin 2025 tek zyra e kuvendit 350,510E, ndërsa ne është viti i tretë i mandatit dhe po kemi shumë probleme me kushte elementare. Me reflektuar të paktën te kjo shpërndarje dhe në buxhetin final dhe me pas një lloj zotimi që i rrinë mbrapa deri në fund që me u zbatuar ashtu si votohet dhe buxheti final. Më gëzon fakti që ka një rritje te subvensionet nga 400,000.00 shkon në 700.000.00E, pothuajse dyfishim.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro Labinot!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Është shqetësues për mua personalisht mos prezenca e drejtorëve të qeveris komunale. Në seancë të jashtëzakonshme KAB-i nuk vjen në asnjë formë sepse të vetmen urgjencë e ka afatin ligjor dhe kemi mundur të paktën në seancë të rregullt me trajtuar këtë, me pas 7 ditë para seancës me trajtuar dhe me jap propozime. Si kuvend jemi të anashkaluar. Raportet financiare duhet të vinë me kohë, KAB- nuk duhet të vijë në seancë të jashtëzakonshme sepse jemi duke fol për buxhet tre vjeçar.

Kryesuesi dhe ne si assemble jemi të obliguar me i respektuar minimumin e kërkesave ligjore. Dëgjimet publike i ceken parafolësit, unë e kam parë vetëm një dëgjim publik.

I vetmi komision që unë e kam konsideruar si më të rëndësishëm në të cilin kam qenë pjesë e hartimit të Rregullores për bashkësi lokale, qëllimi i Rregullores ka qenë me rrit bashkëpunimin në komunitet, mirëpo as këta si bashkësi lokale nuk po respektohen.

Është shqetësuese mos prezenca e drejtorëve komunal, kujt ti drejtohem ne. Me Statut të ri kemi bërë dhe dy drejtori të reja që me funksionalizuar qeverinë komunale më shumë, e kemi drejtorin e zhvillimit ekonomik, unë asnjëherë se kam parë, cilat janë objektivat e asaj drejtorie nuk kemi asgjë.

Në faqe 7 te grantet, te buxheti total vit pas viti ka rritje, kjo është në rregull. Ka rënie tek granti i shëndetësisë që për mua është shqetësuese, për arsye se ne e kemi pasur dhe në program ne duhet të shkojmë drejt dencentralizimi i shërbimeve shëndetësore. Pse mos me i funksionalizuar dhe në disa Bashkësi Lokale qendrat e tilla.

Bujqësia dhe pylltaria po e shohë në vitin 2024 janë 182,000E, ndërsa vitev të tjera pasuese ka rënie diku 50,000E tek stafi, cila është arsyeja. Objektivat që i ka paraparë korniza afatmesme janë mekanizmat se ku do merren ato mjete si do realizohen.

Faqe 11 e keni taks për ushtrimin e veprimtaris, aktualisht është 15,000E, në vitin 2025 është 75,000E mandej ka rënie drastike prej 65,000E që është në kundërshtim me objektivin e juaj.

Qiraja nga objektet publike edhe në mandatin e kaluar kemi kërkuar listë te pronave që komuna merr çera, asnjëherë nuk ka ardhur, këtu është e paraparë 40,000-45,000E dhe ne si kuvend nuk e kemi me list të pronave publike ku komuna merr qera.

Taksa komunale për leje ndërtimi 46,000E, ndërsa në viti 2025 është 85,000E në vitin 2026 është 200,000E. Flugu më i madh i ndërtimeve parashihet në vitin e ardhshëm kur është vit zgjedhor.

Unë konsideroj që prioriteti i qeveris komunale është me i hartuar hartat zonale, po në mungesë të këtyre hartave vjen në shprehje ligji i ndërtimit që në Malishevë nuk është duke u respektuar.

Shikoni objektet që janë duke u ndërtuar pa asnjë kriter as të hapësirave gjelbëruese, as të ndërtimit, as të parkingjeve.

Taks për shfrytëzimin e pronës publike në vitin 2025 janë 22.000E.

Taks për mbeturina aktualisht është 4800E, ndërsa në vitin 2025 është zero, në vitin 2026 është 260,000 ndërsa në vitin e fundit rriten 275.000E.

Të hyrat nga participimi në arsim jo formal, ne e dimë që arsimi jo formal ju është bartur Agjensionit, mirëpo të hyrat në arsim nuk guxojnë të jenë zero. Në shkollën ku punoj ka të hyra një euro paguan nxënësi, 20E një diplomë dhe të gjitha vitet pasuese figurojnë zero. Është mandati i vetëm ku unë jam dhe po e përmbyllim vitin ku nuk kemi raport të drejtorisë së arsimit. Të dhënat që vinë për rënie drastike të nxënësve në nivel Kosove dhe në Malishevë që janë shqetësuese dhe ne parashohim rritje të grantit. Mos të tingëllon kjo që jam kundër rritjes së grantit në arsim.

Te rritja e investimeve kapitale- nga qeveria komunale është thënë që në të gjitha fshatrat e komunës së Malishevës pothuajse 90% është infrastruktura e përmbyllur gjë që me këtë buxhet e demanton dhe tereni, sepse nuk ka fshat që nuk ka probleme në infrastrukturë.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtore për Buxhet dhe Financa): Është e vërtetë që sot është afati i fundit, mirëpo nuk është faji vetëm tek ne dhe qarkorja ka ardhur me vonesë nga qeveria. Ne jemi munduar që ti kushtojmë rëndësi të ndarja buxhetore, kryesisht të subvencionet dhe tek mallrat dhe shërbimet është një ngrije, vetë fakti që kemi obligime por dhe të marrim obligime të reja për vitin 2025. Tek subvencionet kemi bërë planifikimin e rritjes edhe për arsye se kemi shërbime që kryhen si shërbimet e varrimit, shërbimet e tjera dhe fokuset tek bujqësia. Tek mbeturinat është planifikuar që inkasimin ta marr komuna në këtë vit mirëpo ai proces me sa shihet ka dështuar dhe shërbimet prapë do të kryen Ekoregjioni dhe ne nuk mundemi me planifikuar për vitin 2025. E kemi obligim që të aprovohet KAB-i.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Dihet që tavanin e të hyrave caktohet nga Ministria, ne është hera e dytë që po bëjmë kërkesë për rritjen e tavanit të të hyrave. A mendoni që në të ardhmen mundeni me pa problem që ta bëni rritjen e tavanit 2.000.000E, bie numri i popullsisë dhe mundet me kriju telashe vetvetit. Tek grandet e performancës një prej kritereve është grumbullimi i të hyrave vetanake.

Blerim Thaçi (Drejtore për Buxhet dhe Financa): Për vitin 2025 e kemi planifikimin duke u mbështetur dhe në këtë vit dhe në vitin e kaluar ku do të është fokusi i rritjes së të hyrave. Ne mendojmë që dhe këtë vit ta tejkalojmë 2.000.000E.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Përcaktimi i tavanit të të hyrave vetanake për nivelin lokal bëhet në bazë të një vendimi që e nxjerr ministri, ku kërkon që para se me ardhur qarkorja e parë buxhetore realizimin e tri viteve të fundit duke mos e përfshirë vitin aktual, merret mesatarja dhe pastaj ata e planifikojnë sa ka me qenë tavani i të hyrave.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: E hedhi në votim kërkesën e Drejtorisë për buxhet e financa, kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2025-2027. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 8

Abstenim: 1

Me 14vota për, 8 kundër dhe një abstenim miratohet kjo pikë. Shkojmë në pauzë kthehemi në ora: 13:00.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Kthehemi pas pauzës për të vazhduar me pikën e tretë të rendit të ditës.

Pika e tretë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 04/571 datë:24.06.2024 për rritjen e kufirit të të hyrave vetanake për vitin 2024. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Për rritjen e kufirit të të hyrave vetanake është për arsye se në muajin korrik hyjmë në pjesën e mjeteve që grumbullon dhe që nuk janë të aprovuara nga Kuvendi dhe ne mundemi të kryejmë shpenzim pa aprovimin e juaj. Kisha kërkuar që kjo kërkesë të aprovohet.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Drejtor, ti e dinë që një projekt kur të bëhet ai duhet ti ketë dhe mjetet e zotuar. Vitin e kaluar keni dërguar mjete këtu, këtë vit prapë mjetet për parkun në Mirushë shkojnë, kemi prapë mjete për kolektorin e ujërave të zeza. Si është e mundur që mjete po ndajmë çdo herë për të njëjtat projekte, ndaj me projekt buxhet, me rritjen e tavanit të të hyrave vetanake, hiq mjete nga një projekt dhe vendos këtu. Kjo po më duket shumë e pa kuptimtë. Të gjitha këto mjete duhet ta kenë një projekt të ri, një kod të ri buxhetor ku do të investohet. A ka pasur mjete të zotuar kur është bërë projekt buxheti.

Tek pjesa ku thuhet asfaltim nëpër fshatra, po me duket jo serioze, kur thuhet asfaltim nëpër fshatra. Në cilat fshatra, specifikoj që ta dimë që ku janë duke shkuar këto mjete. Nuk jam kundër projekteve, por jam kundër kësaj forme. Dua një sqarim ku po mbeten ato mjete, dhe tani po kërkon prapë mjete shtesë që të vendosen po në ato projekte.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Sa herë që kemi kësë kërkesë ne duhet me i prit mirë ku kërkohet me u rrit niveli i të hyrave, përkatësisht tavanit i të hyrave vetanake. Tek fshatrat, drejtor është mirë me i specifiku. Ligji e thotë që fillimisht duhet të buxhetohen projektet ekzistuese pastaj nëse ka tepriçë të mjeteve mundesh me nis si projekte të reja. Tek subvencionet, tek blloku kodues 47013 është fjala për subvencione në bujqësi sepse 90% në në asamble nuk i dimë kodet. 50.000E janë kërkuar për subvencione në bujqësi. Kërkesa ime është kështu, në qoftëse këto 2.2 milion euro, po e supozoj mblidhen 1.5 milion ato 1.5 me u shpërnda në mënyrë racionale tek të gjitha këto kategori që janë këtu dhe jo vetëm tek dy projekte.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Unë desha të lidhem me rastin e parkut në Mirushë, me sa kujtoj është e financuar nga Ministria e ambientit dhe e komunës dhe ka kushtuar 250,000E si projekt, mirëpo kuvendi, komuna po i sjellë që dy herë nga 100,000E. A ka mundësi me na sqaruar pse ka ardhur dy herë nga 100,000E rreth këtij projekti.

Drejtor, kisha kërkuar të mos përsëriten projektet copy-paste edhe projektet fiktive sepse nëse ndokujt mundet me i kushtu.

Në Damank është përfunduar trotuari në vitin 2016 dhe prapë del nëpër projekt buxhete. Është ujësjellësi i Gajrakut ato janë projekte fiktive të paqena.

Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kodet vlejné për brenda një institucioni të caktuar, kodet nuk vlejné në kuvend. Ne këtu nuk jemi shërbime informative për me funksionuar me kode, shumë e thjesht është kodin me e kthyer në atë që kodi përfaqëson dhe e dimë çka po subvencionojm.

Ajo çka mua më shqetësoj është pika ku ndahen 30,000E për rinovimin e shkollave. Si mundën me u rinovuar 10 shkolla me 30,000E. Më mirë ka qen me i kordinuar gjërat edhe këto 30.000E me qen për rinovimin e një shkolle ose me rinovimin e oborrit të ndonjë shkolle. Në projekt buxhet ka qenë 2 herë rregullimi i oborrit të shkollës në Astrazup dhe këtu mjete kemi mundur me i përdor këtu ose në oborrin e ndonjë shkollë tjetër.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Është mirë që kemi kërkesa për rritjen për tavanin buxhetor për të hyrat vetanake e cila pastaj reflekton dhe me mundësi shtesë për investime të tjera kapitale për të mirë të qytetarëve. Ajo që është bërë praktik për disa herë, po ka një lloj “monopoli” të projekteve të cilat po dominojnë pastaj në këtë buxhet që po vjen prej të hyrave vetanake ndoshta më mirë është me orientuar dhe në projekte tjera. 800.000E janë paraparë te projekti për ndërtimin e sheshit këtu në qendër të Malishevës. Ne në këtë projekt përveq buxhetit vjetor shumicën dërmuese, po dominon dhe në pjesën e kategorisë së të hyrave vetanake. Në secilin fshat që shkon sheh nevoja urgjente për me ndërhyrë. Ndoshta është mirë kur të miratohet të ketë një shpërndarje të rrugëve nëpër fshatra dhe kur të bëhet si vendim të del saktë për cilat rrugë po bëhet fjalë.

30,000E shuma për shkolla është shumë e vogël, mirëpo realisht në shumicën e këtyre shkollave janë shkolla të reja që janë dhënë në shfrytëzim ndoshta vitin e kaluar. E kemi shkollën në Senik, Bubavec, Bardh, Astrazup janë të reja, ndërsa janë disa shkolla të vjetra të cilat nuk janë të figuruara këtu. Këto mjete as për një shkollë nuk janë të mjaftueshme, unë e kam cek dhe më herët që shkollat duhet të pajisen me kamera digjitale dhe shihet se nga kush po dëmtohen. Ne si grup gjithmonë kemi thënë që kur bëhet fjala për subvencione në bujqësi ne kemi me i votuar.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Parimisht për me pas mundësi ne për me vendos mjetet në një projekt në këtë fazë, fillimisht ai projekt duhet me qenë i planifikuar në buxhet nga burimi i të hyrave vetanake. Sa më shumë që përfundohen këto projekte neve na lehtëson dhe na krijon hapësirë që me fut sa më shumë projekte të reja në buxhetin që kemi me bërë tani në shtator.

Sa i përket bujqësisë unë shpesh rri me drejtorin dhe këta janë shumë aktiv dhe në gjetjen e fondeve dhe organizatave të cilat financojnë, por këto organizata që financojnë e kanë si kriter formën e bashkëfinancimit dhe kjo ka qenë njëra nga arsyet pse Drejtoria e Bujqësisë i ka kërkuar 50,000E.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Rritja e të hyrave vetanake na gëzon të gjithëve por tek shpërndarja në projekte ekzistuese ne mundemi ta bëjmë më ndryshe më drejt, por kjo është propozim që është ardhur nga drejtoria. Projekti më i madh që gjendet në Malishevë është dhe me buxhet të rregullt 50% të buxhetit të investimeve kapitale i merr ai projekt. Në vitin e kaluar kemi ndarë prapë 800,000E për shtratin e Lumit Mirusha deri tek tranziti.

Tek asfaltimi i rrugëve- asfaltimi i rrugëve në fshatin Kijevë nuk ceket ndërsa të tjerat janë të specifikuara me metër. Këtë praktik nuk kisha preferuar me zgjat, por të paktën prej të hyrave vetanake që i votojmë këtu është mirë me u realizuar. Të gjitha ato projekte që janë të koduara këtu janë ekzistuese, p.sh ne kemi nevojë shumë me e rrit buxhetin tek qështja e kanalizimit sepse të gjitha fshatrat kanë probleme.

Tek asfaltimi i rrugëve me buxhet të rregullt i kemi ndarë 500,000E që disa janë të specifiku me emër dhe tani po kërkon prapë 700,000E, atëherë do të thotë që ne si qeveri komunale nuk i kemi planifikuar mirë.

Qa mundesh të bësh me 30,000E më shumë se 15 shkolla. Konsideroj që shpërndarja ka mundur të jetë më e drejtë.

Pajtohem tek subvencionet në bujqësi. Tek kategoria mallra dhe shërbimeve ne vazhdimisht me qeverinë komunale duhet të bëjmë përpjekje me i ulë sepse ato janë shpenzime te luksit.

Ne e kemi marr një vendim që 30,000E i kemi ndarë për pagesën e komisioneve dhe asgjë nuk ka lëviz.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Shumica e anëtarëve të kuvendit u pajtuan tek pika e rinovimit të shkollave që shuma është shumë e vogël. Propozimi im është që 50,000E me u heq nga pika e kanalizimeve dhe me u vendos tek renovimi i shkollave.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtori për Buxhet dhe Financa): Tek kodet një sqarim, të gjitha këto të hyra që krijohen shtesë janë nga kodet që ju i keni aprovuar me buxhet dhe në buxhet i keni dhe emërtimet. Unë pajtohem me ju që herave të tjera ju sjelli dhe kodin se qka paraqet.

Sa i përket parkut është me përqindje të participimit 50-50 komuna dhe Ministria, pa përfshirë punën shtesë që nuk e merr Ministria, por e merr komuna. Ne në këtë vit i kemi pasur të planifikuara 100,000E për parkun në Mirushë, detyrimisht me marrëveshje i kemi dhe 35,000E shtu dhe 10% që do të jetë pjesë e këtij projekti është totali i asaj vlerës që do të mbyllet kontrata. Kontrata është dy vjeqare dhe ajo do të mbyllet këtë vit.

Tek rrugët nuk mundemi me lëvizë. Dhe rrugët janë emërtime të gjitha në buxhet janë se sa janë të planifikume.

Tek qështja e rinovimit të shkollave- kjo është për objekte shkollore, tani është nënshkruar një kontratë dy vjeqare me vlerën prej 500,000E, ndërsa për këtë vit sipas planifikimit të buxhetit kanë qenë 50,000E, ia shtojmë dhe këtë 30,000E d.m.th është 80,000E. Totali me këtë shtesë për rinovimin e shkollave është 80,000E.

Rregullimi i shtratit të Lumit, ju e dini që kemi fituar një grand nga performanca dhe është bërë projekti dhe është planifikuar që të rregullohet shtrati i lumit me Grantin nga performanca, pjesa e parë këtë vit ndërsa pjesa tjetër vitin e ardhshëm. Tek rrugët ju mund ti hiqni por mbesin pa u realizuar kontratat, dhe kontrata është brenda këtij viti ndërsa te këto tjerat projekte nëse grumbullohen këto mjete neve do të na lehtësonte për vitin e ardhshëm. Çdo projekt që e kemi sjell tek ju është me kontratë 3 vjeqare dhe në qoftëse nuk realizohet shpenzimi dhe obligimet

ndaj këtyre projekteve në vitin e ardhshëm do të jemi më të liruar për investime të reja. Në buxhet keni planifikuar dhe rrugë të reja që në fund të gushtit planifikohen që të inicohen procedurat. Për bujqësi duhet me falënderu dhe drejtorin i cili është në prag të marrëveshjes me një donator të jashtëm dhe ky 50,000E shkon në kuadër të marrëveshjes. Projekti për ndërtimin e ambullantës të shtëpisë së shëndetit në Kijevë është në prag të nënshkrimit dhe do jetë pjesë e planifikimit që kemi pasur 50,000E.

Kryesuesi i Kuvenit Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo): Sa i përket rinovimeve të shkollave unë kam një pyetje. Për qfarë rinovime po flasim, kur kemi të bëjmë me disa shkolla që shumë vonë janë ndërtuar. Me rinovim të këtyre shkollave kuptojmë shpenzim i kotë sepse në ato objekte shkollore kemi ngecur gjatë fazës së ndërtimit, këtu kemi të bëjmë me ndërtime skandalozë dhe të mbikqyrura ashtu siç duhet. Para se të destinojmë mjete për rinovim dikush duhet të jap llogari për ndërtimin e tyre skandaloz. E kemi shkollën në fshatin Bardh, ku objekti nuk ka kohë shumë që është ndërtuar, mirëpo forma si është ndërtuar ka qenë skandaloz që do të thotë që dhe nëse ne 100,000E i ndajmë për atë objekt prapë ai objekt nuk do ta merr formën dhe pamjen siç duhet sepse ndërtimi që në start ka qenë skandaloz.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Propozimin që e kisha më herët po e tërheqi. Ajo çka më shqetëson është neglizhenca dhe papërgjegjësisë së ekzekutivit që pritojnë një shifër koduese me kthyer se për çka po destinohen. Kjo është hera e fundit që unë votoj këso me kode.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Shkojmë në votim me shpresë që herave të tjera drejtori ta sjellë sipas kërkesave të anëtarëve të kuvendit, 24 anëtarë janë prezent. Kush është për kërkesën nr.04/571 datë:24.06.2024, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2024?

Për:15

Kundër: 6


Abstenim: 3

Me 15 vota për, 6 kundër dhe 3 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Tek pika të ndryshme a e dëshironi fjalën. Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

